

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje fishekzjarre për festat e fundvitit”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 24613200-6**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2.916.464 (dy milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale për importin, eksportin dhe prodhimin e lëndëve piroteknike, fishekzjarre për përdorim civil, nga AKSHE (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve).

**Argumentimi:** *Këto kritere u vendosën në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin Nr. 73/2021 për "Hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë", ligjin Nr. 73/2014 për "Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9126, datë 29.7.2003, "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë", (të ndryshuar), VKM Nr. 932, datë 18.11.2015 për "Procedurën për dhënien e licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil", ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 për "Mbrojtjen e Mjedisit" si edhe në parashikimet e bëra në nenin 77, të Ligjit të posaçëm Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenin 40 pika 5 gërma (a) të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". **Këto kritere gjithashtu janë vendosur nga AK duke marrë në konsideratë edhe faktin se operatori ekonomik fitues do të kryejë shërbimin e montimit, plasjes dhe pastrimit të ambientit pas perfundimit të festes, si dhe duke qene se menaxhimi i këtyre lëndve ka rëndësi jetike dhe në këtë mënyrë është mbajtur parasysh të kerkohen licensat sa me siper cituar.***

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2022, 2023**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës;

**2.2.2.** Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (**2022, 2023**) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

**Argumentimi:** *Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

*"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar ...”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

**2.2.3.** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

*Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.*

*Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo

*më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2** Operatori ekonomik të deklarojë se merr përsiper të realizojë shërbimin e montimit plasjes dhe pastrimit e ambientit pas perfundimit të festës me stafin e operatorit ekonomik të licensuar sipas akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi.

***Argumenti:** Duke qënë se këto artikuj janë të një rëndësie të vecantë jetike dhe procesi i plasjes së tyre ka impakt të drejtpërdrejtë në komunitet është kërkuar që ofertuesit e mundshëm ekonomikë të marrin vetë përsipër të kryejnë procesin e shërbimit të montimit, plasjes dhe pastrimit të ambientit duke qënë se kanë staf të specializuar dhe kualifikuar për realizimin me sukses të këtij shërbimi.*

**2.3.3** Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale për realizimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë personel teknik/ 1 (një) Person me njohuri të specializuara në përdorimin e lëndëve piroteknike, i pajisur me dëshmi Zjarrmëtari (e vlefshme) lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatën/ dëshmin për punonjësin e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve;
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

*Kriteri 2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Kërkesa e vendosur nga AK për disponimin e personelit teknik/ Person me njohuri të specializuara në përdorimin e lëndëve piroteknike, i pajisur me dëshmi Zjarrmëtari (e vlefshme) është e domosdoshme pasi ky person zotëron njohuritë e duhura për realizimin e të gjithë procesit të montimit, plasjes e deri në pastrimin e ambientit nga mbetjet e lëndëve piroteknike për të shmangur çfarëdolloj problematike që mund të dalë gjatë procedurës së hedhjes së fishekzjarreve.*

*Rrjedhimisht AK mund t’u kërkojë ofertuesve të mundshëm ekonomikë të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është*

vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmerinë, cilësinë dhe kapacitetet e ofertuesve. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

*Shënim: Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës i referohet pikës 1 dhe pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021. Ndersa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

**2.3.4** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Një mjet transporti të pajisur me certifikatën ADR "Për transportin e mallrave të rrezikshëm", (e vlefshme) e lëshuar nga Autoriteti përkatës

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;
- leje qarkullimi;
- certifikatën e kontrollit teknik;
- siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
- certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

b) Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij;
- leje qarkullimi;
- certifikatën e kontrollit Teknik
- siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
- certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Kriteri 2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**

Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve të punës sa me sipër cituar lind e nevojshme edhe disponimi i mjetit të transportit i pajisur me certifikatën ADR "Për transportin e mallrave të rrezikshëm".

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Me qëllim krijimin e një atmosfere festive dhe argëtimi për qytetarët, Bashkia e Tiranës natën e ndërrimit të viteve ka menduar të organizojë një shfaqje (spektakël) fishekzjarrësh. Nga ana e Autoritetit Kontraktor është hartuar një listë e llojeve të ndryshme të fishekzjarrëve.

Përzgjedhja e modeleve si më poshtë shënuar është bërë me qëllim krijimin e një pamjeje panoramike dhe fushëpamje të gjerë në mënyrë që të shihen masivisht nga qytetarët e Tiranës dhe sigurisht të ofrohet dhe siguria maksimale e tyre.

### 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Single Shot 1.2" (Tek gjuajtje 1.2")	copë	30
2	Single Shot 2" (Tek gjuajtje 2")	copë	15
3	Predha për shfaqje 3inch	copë	170
4	Predha për shfaqje 4inch	copë	50
5	Predha për shfaqje 5inch	copë	50
6	Predha për shfaqje 6inch	copë	9
7	Tortë në një rrjesht 7s Ø30mm	copë	20
8	Tortë në një rrjesht 9s Ø30mm	copë	20
9	Tortë në një rrjesht 10s Ø30mm	copë	20
10	Tortë në një rrjesht 11s 30mm	copë	20
11	Tortë në një rrjesht 13s 30mm	copë	20

<b>12</b>	Tortë 36s Ø30mm	copë	30
<b>13</b>	Tortë 48s 30mm	copë	20
<b>14</b>	Tortë 49s Ø25mm	copë	4
<b>15</b>	Tortë 49s 30mm	copë	9
<b>16</b>	Tortë 90s Ø25mm	copë	3
<b>17</b>	Tortë 100s Ø30mm	copë	9
<b>18</b>	Tortë 150s Ø30mm	copë	5
<b>19</b>	Tortë 300s Ø15mm I-shape	copë	30

***1.Specifikimet teknike për predhë (Predhë për shfaqje fishekzjarresh):***

1. Të jenë per perdorim professional.
2. Te kene klasifikim e KB-se per rrezikshmeri .(Kategoria F3/F4 OSE 1.3/1.4)
3. Ndezja e tyre behet, sipas kushteve dhe normave te perdorimit
4. Numri I gjuajtjeve eshte teke per cdo product
5. Diametri I predhave eshte 3 inch, 4 inch, 5 inch, 6 inch
6. Forma e predhave eshte sferike dhe efekti i shperthimit miks ngjyrash dhe lulesh.
7. Strukturat ku montohen predhat duhet te kene ne bazament te qendrushme mbeshtetes, me qellim forca e shperthimit te mos leviz strukturen, per te amortizuar sa me shume fuqine shperthyese te saj. Te fiksohet me pesha te renda me material te papershkrueshme nga zjarri.
8. Shperthimi eshte I komanduar nga pulti, I sinkronizuar per shperthimin sipas koreografise, rradhes , se prdukteve qe shperthejne, minutazhit, kohezgjatjes.
9. Te leshohen me grykemortaja prej alumini ose(materiale te pandezshem , PVC, fiberglass)
10. Te jene te sigurta teknikisht per te siguruar dhe garantuar shperthimin. Montohet dhe lidhet me telin percjelles.
11. Ambalazhi te garantoje sigurimin e produktit kundra djegies dhe lageshtires.

***2.Specifikimet teknike per fishekzjarre – kuti shperthyese te emertuara “Torte”.***

1. Të jenë per perdorim professional.
- 2.Te kene klasifikim e KB-se per rrezikshmeri .(Kategoria F2/F3/F4 OSE 1.3/1.4)
3. Ndezja e tyre behet, sipas kushteve dhe normave te perdorimit
4. Numri i gjuajtjeve të jetë 7 deri ne 300 gjuajtje per produkt
5. Diametri I tubave qe perbejne produktin Torte te jete nga 15mm deri ne 30mm

6. Format e shperthimit te jene ovale (C-Shape), mikes (MIX-shape), I-shape, W-shape.
7. Te fiksohet me pesha te renda me material te papershkrueshme nga zjarri.
8. Ambalazhi te garantoje sigurimin e produktit kundra djegies dhe lageshtires.

### **3. Specifikimet teknike per fishekzjarre kuti shperthyese “Torte ne nje rrjesht”**

1. Të jenë per perdorim professional.
2. Te kene klasifikim e KB-se per rrezikshmeri .(Kategoria F4 OSE 1.3)
3. Ndezja e tyre behet, sipas kushteve dhe normave te perdorimit.
4. Numri i gjuajtjeve të jetë 7 deri ne 13 gjuajtje njekohesisht per produkt
5. Diametri I tubave qe perbejne produktin Torte ne nje rrjesht te jete nga 15mm deri ne 30mm
6. Format e shperthimit te jene forme harku (Fun-shape), bishtpallua
7. Te fiksohet me pesha te renda me material te papershkrueshme nga zjarri.
8. Ambalazhi te garantoje sigurimin e produktit kundra djegies dhe lageshtires.

### **4. Specifikimet teknike per fishekzjarre Singel shot (tek gjuajtje)**

1. Të jenë per perdorim professional.
2. Te kene klasifikim e KB-se per rrezikshmeri .(Kategoria F4 OSE 1.3)
3. Ndezja e tyre behet, sipas kushteve dhe normave te perdorimit.
4. Numri i gjuajtjeve është teke.
5. Diametri I tubit te jete 1.2 inch deri ne 2 inch.
6. Forma e “Singel shot” eshte cilindrike, dhe efekti I shperthimit tek gjuajtja, komete, miks ngjyrash.
7. Strukturat ku montohen Singel shot duhet te kene nje bazament te qendrueshem mbeshtetes. Struktura te fiksohet me pesha te renda me material te papershkrueshem nga zjarret.
8. Shperthimi eshte I komanduar nga pulti, I sinkronizuar per shperthimin sipas koreografise, rradhes , se prdukteve qe shperthejne, minutazhit, kohezgjatjes. Montohet dhe lidhet me telin percjelles.
9. Te leshohen me strukture prej alumini ose(materiale te pandezshem , PVC, fiberglass)
10. Te jene te sigurta teknikisht per te siguruar dhe garantuar shperthimin. Montohet dhe lidhet me telin percjelles.



11. Ambalazhi të garantojë sigurimin e produktit kundër djegies dhe lageshtires

*Siguria e hapësirës/terrenit dhe distanca:*

Në hapësirën/terrenin ku do shpërthejnë fishekzjarret, produktet vendosen në një terren të sheshtë me një sipërfaqe 100-150 m<sup>2</sup>, sigurohet që hapësira lart mos të ketë asnjë pengesë që mund të kryqëzohet me shpërthimin e fishekzjarreve.

Në hapësirën/terrenin ku do të montohen fishekzjarret, të respektohet një distancë 20 m minimale nga çdo kategori produkti me njëri tjetrin (torta/kuti shpërthyes, struktura/kombinim për predha për shfaqje, struktura/kombinim për tuba roman candel.

Në hapësirën/terrenin ku do shpërthejnë fishekzjarret të respektohet një distancë minimale 50-60 metra nga njerëzit që do shijojnë shpërthimin e fishekzjarreve.

Për të rritur shkallën e sigurisë së personelit të Bashkisë së Tiranës dhe qytetarëve të Tiranës, operatori lëndët piroteknike (fishekzjarret) do të mbajë gjendje në deponë e tij të licencuar dhe do të nxjerrë në datën e orën që do të përcaktohet në kontratë. (datë 31.12.2024 ora 24.00)

Operatori ekonomik të projektojë fishekzjarret dhe të kombinojë imazhet e tyre me qëllim krijimin e spektaklit.

Operatori duhet të ofrojë shërbimin e montimit, plasjen dhe pastrimin e ambientit pas përfundimit të festës me stafin e operatorit ekonomik të licencuar sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Transporti duhet të bëhet nga operatori fitues me mjet të pajisur me leje për transportimin e mallrave të rrezikshëm (ADR-në).

**NJËSIA E PROKURIMIT**